



**“Службен гласник на
Општина Гостивар”**

Излегува по потреба

**“Buletini zyrtar i
Komunës së Gostivarit”**

Botohet sipas nevojës

Бр./Nr. 8
Гостивар / Gostivar



Бр.№р.08-1151/1
21.09.2009
Гостивар/Gostivar

Врз основа на член 50 став 1 точка 3 од Законот за локална самоуправа (“Службен Весник на РМ” бр.5/02), Градоначалникот на Гостивар го донесе следново:

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.5/02), Kryetari i Komunës së Gostivarit, solli:

РЕШЕНИЕ

за прогласување на Заклучокот за реализација на Буџетот на Општина Гостивар за II квартал за 2009 година .

AKTVENDIM

për shpallje të Konkluzionit për realizim të buxhetit të komunës së Gostivarit në kuartalin e II për vitin 2009.

Се прогласува Заклучокот за реализација на Буџетот на Општина Гостивар за II квартал за 2009 година бр.07-1139/1 која Советот на Општина Гостивар ја донесе на седницата одржана на 18.09.2009.

Shpallet Konkluzioni për realizim të buxhetit të komunës së Gostivarit në kuartalin e II për vitin 2009.nr.07-1139/1 që Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë 18.09.2009.

Градоначалник
Kryetari i Komunës
Dr. Rufi Osmani d.v.



Совет на Општина Гостивар
Këshilli i Komunës së Gostivarit
Бр. Nr.07-1139/1
18.09.2009
Гостивар/Gostivar

Врз основа на член член 32 став 2 од Законот за финансирање на едиците на локалната самоуправа (“Службен весник на РМ“ бр.61/04), и член 144 од Деловникот за работа на Советот на Општина Гостивар („Сл. гласник на Општина Гостивар,, бр.1/06), Советот на Општина Гостивар на седница одржана на 18.09.2009 година, донесе:

Në bazë të nenit 32 paragrafi 2 të ligjit për finansim të njësive të vetqeverisjes lokale (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.61/04), dhe nenit 144 të Rregullores për punën e Këshillit të Komunës së Gostivarit (“Buletyni Zyrtar i komunës së Gostivarit” nr.1/06), Këshilli i Komunës së Gostivarit në mbledhjen dyzetedytë të mbajtur më 18.09.2008, solli

ЗАКЛУЧОК

За усвојување на квартален извештај-II за извршување на буџетот на Општина Гостивар за 2009 година

1. Се усвојува кварталниот извештај-II за извршување на буџетот на Општина Гостивар за 2009 година .

2. Составен дел на овој Заклучок е и извештајот за извршување буџетот на Општината Гостивар.

3. Овој Заклучок стапува во сила со денот на донесувањето а ќе се објави во “Службен гласник на Општина Гостивар”.

KONKLUZION

për miratimin e raportit kuartal-II për realizimin e buxhetit të Komunës së Gostivarit për vitin 2009

1. Miratohet raporti kuartal-II për realizimin e buxhetit të Komunës së Gostivarit për vitin 2009 .

2. Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe raporti për realizimin e buxhetit të Komunës së Gostivarit.

3. Ky Konkluzion hyn në fuqi me ditën e sjelljes dhe do të shpallet në "Buletinin zyrtar të Komunës së Gostivarit".

Председател на Совет
Kryetari i Këshillit
Dr. Fadil Zendeli d.v.



Бр.Нр.08-1151/2
21.09.2009
Гостивар/Gostivar

Врз основа на член 50 став 1 точка 3 од Законот за локална самоуправа (“Службен Весник на РМ” бр.5/02), Градоначалникот на Гостивар го донесе следново:

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.5/02), Kryetari i Komunës së Gostivarit, solli:

РЕШЕНИЕ

за прогласување на Одлуката за делумно поништување на одлуките за субвенционирање и распределување на средствата од буџетот на Општина Гостивар на Јавните претпријатија.

Се прогласува Одлуката за делумно поништување на одлуките за субвенционирање и распределување на средствата од буџетот на Општина Гостивар на Јавните претпријатија бр.07-1140/1 и 07-1140/2 која Советот на Општина Гостивар ја донесе на седницата одржана на 18.09.2009.

АКТ ВЕНДИМ

për shpallje të Vendimit për anulim të pjesërishëm të vendimeve për subvencionim dhe sistemim të mjeteve të buxhetit të Komunës së Gostivarit Ndërmarrjeve publike .

Shpallet Vendimi për anulim të pjesërishëm të vendimeve për subvencionim dhe sistemim të mjeteve të buxhetit të Komunës së Gostivarit Ndërmarrjeve publike nr.07-1140/1 dhe nr.07-1140/2 që Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë 18.09.2009.

Градоначалник
Крыетари i Komunës
Dr. Rufi Osmani d.v.



Совет на Општина Гостивар
Këshilli i Komunës së Gostivarit
Бр/ Nr.07-1140/1
18.09.2009
Гостивар/ Gostivar

Врз основа на член 142 од Деловникот за работа на Советот на Општина Гостивар (Сл.гласник бр.1/06), Советот на Општина Гостивар на седница одржана на 18.09.2009 донесе :

Në bazë të nenit 142 të Rregullores për punë të Këshillit të Komunës së Gostivarit (Bul. zyrtar nr. 1/06) Këshilli i Komunës së Gostivarit në mbledhjen e mbajtur më 18.09.2009 solli :

Одлука

Vendim

**за делумно поништување на Одлука за
распodelување на средства**

**për anulim të pjesërishëm të Vendimit për
sistemim të mjeteve**

1. Со оваа Предлог – Одлука делумно се поништува одлуката бр.07-59/1 за распоредување на средства од буџетот на Општина Гостивар на Јавното Претпријатије Гостивар – Гостивар

1. Me këtë Propozim – Vendim anulohet pjesërisht vendimi nr. 07-59/1 për sistemim të mjeteve të buxhetit të Komunës së Gostivarit Ndërmarrjes Publike Gostivar - Gostivar .

2.Износот на поништување на распоредените средства е 5.671.831 денари.

2. Vlera e anulimit të mjeteve për sistemim është 5.671.831 den.

3. Оваа Предлог - Одлука влегува во сила со денот на донесувањето и истата ќе се објави во "Службен гласник на Општина Гостивар".

3. Ky Propozim - Vendim hyn në fuqi ditën e sjelljes dhe i njëjti do të shpallet në "Buletinin Zyrtar të Komunës së Gostivarit ".

Председател на Совет
Kryetari i Këshillit
Dr. Fadil Zendeli d.v.



Совет на Општина Гостивар
Këshilli i Komunës së Gostivarit
Бр/№р.07-1140/2
18.09.2009
Гостивар/ Gostivar

Врз основа на член 142 од Деловникот за работа на Советот на Општина Гостивар (Сл.гласник бр.1/06), Советот на Општина Гостивар на петата седница одржана на 18.09.2009 донесе :

Në bazë të nenit 142 të Rregullores për punë të Këshillit të Komunës së Gostivarit (Bul.zyrtar nr.1/06) Këshilli i Komunës së Gostivarit në mbledhjen e pestë të mbajtur më 18.09.2009 solli :

Одлука

за делумно поништување на Одлуката за распределување на средства

1. Со оваа Одлука делумно се поништува одлуката со бр.07-57/1 за субвенционирање на средства од буџетот на Општина Гостивар на ЈПССО, „Риниа, Гостивар

2.Износот на поништување на субвенционираниите средства е 287.000 денари.

3. Оваа Одлука влегува во сила со денот на донесувањето и истата ќе се објави во "Службен гласник на Општина Гостивар".

Vendim

për anulim të pjesërishtëm të Vendimit për subvencionim të mjeteve

1. Me këtë Vendim anulohet pjesërisht vendimi nr.07-57/1 për subvencionim të mjeteve të buxhetit të Komunës së Gostivarit NPEOS, „Rinia, Gostivar .

2. Vlera e anulimit të mjeteve për subvencionim është 287.000 denar.

3. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e sjelljes dhe i njëjti do të shpallet në "Buletinin Zyrtar të Komunës së Gostivarit "

Председател на Совет
Kryetari i Këshillit
Dr. Fadil Zendeli d.v.



Бр.№р.08-1151/3
21.09.2009
Гостивар/Gostivar

Врз основа на член 50 став 1 точка 3 од Законот за локална самоуправа (“Службен Весник на РМ” бр.5/02), Градоначалникот на Гостивар го донесе следново:

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.5/02), Kryetari i Komunës së Gostivarit, solli:

РЕШЕНИЕ

за прогласување на Одлуката за ребаланс на буџетот на Општина Гостивар за 2009 година.

AKTVENDIM

për shpallje të Vendimit për rebalanc të buxhetit të Komunës së Gostivarit për vitin 2009.

Се прогласува Одлуката за ребаланс на буџетот на Општина Гостивар за 2009 година бр.07-1141/1 која Советот на Општина Гостивар ја донесе на седницата одржана на 18.09.2009.

Shpallet Vendimi për rebalanc të buxhetit të Komunës së Gostivarit për vitin 2009.nr. 07-1141/1 që Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë 18.09.2009.

Градоначалник
Kryetari i Komunës
Dr. Rufi Osmani d.v.



Совет на Општина Гостивар
 Këshilli i Komunës së Gostivarit
 Бр/№р.07-1141/1
 18.09.2009
 Гостивар/ Gostivar

Врз основа на член 36 став 1 точка 2 од Законот за локална самоуправа и ("Службен весник на Р.М."бр.5/2002) и член 29 од законот за финансирање на единиците на локалната самоуправа („Службен весник на РМ „ бр.61/04 и 96/04), Советот на Општина Гостивар на седницата одржана на 18,09,2009 година, донесе

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 2 e Ligjit për vetadministrim lokal dhe ("Fletorja zyrtare e RM" nr.5/2002)dhe neni 29 të ligjit për financimine njërive të vetqeverisjes lokale("gazeta zyrtare e RM-së" nr.61/04), Këshilli i Komunës së Gostivarit në seancën e mbajtur më 18.09.2009 solli

ОДЛУКА

VENDIM

**ЗА РЕБАЛАНС НА БУЏЕТ
 НА ОПШТИНА ГОСТИВАР ЗА 2009
 ГОДИНА**

**PËR REBALANS TË BUXHETIT TË
 KOMUNËS SË GOSTIVARIT
 PËR VITIN 2009**

Член 1

Neni 1

Буџетот на Општина Гостивар за 2009 година се состои од:

Buxheti i Komunës së Gostivarit për vitin 2009 përbëhet nga:

Буџет	Ребаланс	Buxhet	Rebalans
-Вкупно приходи		-Gjithsej të hyrat	
117.855.605,00 ден.	754.015.991,00	1.117.855.605,00 den.	754.015.991,00
<i>Тековни оперативни приходи</i>		<i>Të hyra operative rjedhëse</i>	
516.516.494.840,00 //	207.926.978,00	516.516.494.840,00 //	207.926.978,00
<i>Приходи од самофин. активности</i>		<i>Të hyra nga aktivitete të vetëfinancimi</i>	
13.709.210,00 //	14,791,210,00	13.709.210,00 //	14.791.210,00
<i>Приходи од донации</i>		<i>Të hyra nga donacionet</i>	45.000.000,00
45.000.000,00			
<i>Приходи од наменски донации</i>		<i>Të hyra na dotaacione të destinuara</i>	
542.651.555,00 //	531,297,803,00	542.651.555,00 //	531.297.803,00
Вкупно расходи		-Gjithsej të dalurat	
1.117.855.605,00 ден.	754.015.991,00	1.117.855.605,00 den.	754.015.991,00
и тоа :		edhe atë:	



<i>Утврдени намени</i>			<i>- Destinime të përcaktuara</i>		
1.111.113.355.605,00	//	750.015.991,00	1.113.355.605,00	//	750.015.991,00
<i>-Резерви</i>			<i>- Rezervat</i>		
4.500.000,00	//	4.000,000,00	4.500.000,00	//	4.000.000,00

Член 2

Neni 2

Приходите по извори и видови на приходи и расходите по основни намени и програми се утврдени во консолидираниот биланс на приходите и расходите на Општина Гостивар во износ од 1.117.855.605,00 денари со ребаланс се заменува со износ од 754.015.991,00 денари за 2009 година и ќе се распоредуваат како што следува:

Të hyrat në bazë të burimeve dhe llojeve të të hyrave dhe të dalave sipas destinimeve të përcaktuara themelore në bilancin egzistues të të hyrave dhe të dalave të Komunës së Gostivarit në shumë prej 1.117.855.605,00 denarë me rebalansin do të zëvendësohen me vlerën prej 754.015.991,00 denarë për vitin 2009 dhe do të radhiten si vijon:

член 3

Neni 3

Ова одлука влегува во сила со денот на донесувањето а ќе се објавува во „Службен Гласник,, на Општина Гостивар

Ky vendim hyn në fuqi me ditën e sjelljes dhe do të shpallet në “Buletinin Zyrtar” të Komunës së Gostivarit.

Председател на Совет
Kryetari i Këshillit
Dr. Fadil Zendeli d.v.



Бр.№р.08-1151/4
21.09.2009
Гостивар/Gostivar

Врз основа на член 50 став 1 точка 3 од Законот за локална самоуправа (“Службен Весник на РМ” бр.5/02), Градоначалникот на Гостивар го донесе следново:

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.5/02), Kryetari i Komunës së Gostivarit, solli:

Р Е Ш Е Н И Е

за прогласување на Одлуката за измена на одлуката со бр.07-872/1 за организирање, делокруг и начин на вршење задачи на Општинската администрација на Општина Гостивар.

А К Т В Е Н Д И М

për shpallje të për ndryshim të vendimit 07-872/1 për organizim, fushëveprim dhe mënyrën e kryerjes së detyrave të administratës Komunale të Komunës së Gostivarit.

Се прогласува Одлуката за измена на одлуката со бр.07-872/1 за организирање, делокруг и начин на вршење задачи на Општинската администрација на Општина Гостивар. бр.07-1142/1 која Советот на Општина Гостивар ја донесе на седницата одржана на 18.09.2009.

Shpallet vendimi për ndryshim të vendimit 07-872/1 për organizim, fushëveprim dhe mënyrën e kryerjes së detyrave të administratës Komunale të Komunës së Gostivarit..nr.07-1142/1 që Këshilli i Komunës së Gostivarit e solli në seancën e mbajtur më datë 18.09.2009.

Градоначалник
Kryetari i Komunës
Dr. Rifi Osmani d.v.



Совет на Општина Гостивар
Këshilli i Komunës së Gostivarit
Бр/Нр.07-1142/1
18.09.2009 год.
Гостивар/Gostivar

Врз основа на член 57 став 4 од Законот за локална самоуправа ("Службен весник на РМ" бр.5/02), а во врска со член 1 од Уредбата за начелата за внатрешна организација на органите на државната управа ("Службен весник на РМ" бр.105/07) Советот на Општина Гостивар на петата седница одржана на 18.09.2009 година, донесе:

Në bazë të nenit 57 paragrafi 4 i Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Fletorja zyrtare e RM" nr.5/02), neni 1 i Dekretligjit për parimet e organizimit të brendshëm të organeve të administratës shtetërore ("Fletorja zyrtare e RM" nr. 105/07), Këshilli i Komunës së Gostivarit në seancën e pestë të mbajtur më 18.09.2009 solli:

ОДЛУКА

За организацијата, делокругот и начинот на извршувањето на задачите на општинската администрација на Општина Гостивар

V E N D I M

Për organizimin, fushëveprimin dhe mënyrën e kryerjes së detyrave të administratës komunale të Komunës së Gostivarit.

I. ОСНОВНИ ОДРЕДБИ

Член 1

Со оваа Одлука се утврдува организацијата, делокругот и начинот на извршувањето на задачите на Општинската администрација на Општината Гостивар (во натамошниот текст Општинска администрација).

Член 2

Се организира општинска администрација за вршење на работата од надлежност на Општината утврдени со Законот за локална самоуправа и посебните закони за одделни области и Статутот на Општината.

Член 3

Општинската администрација:

- Ги подготвува актите за Советот и за Градоначалникот;
- Ги подготвува седниците на

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Me këtë Vendim përcaktohet organizimi, fushëveprimi dhe mënyra e kryerjes së detyrave të Administratës komunale të Komunës së Gostivarit (në tekstin e mëtutjeshëm Administrata komunale).

Neni 2

Organizohet administrata komunale për kryerjen e punëve nga kompetenca e Komunës të përcaktuara me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe ligjet e posaçme për fusha të caktuara dhe Statutin e Komunës.

Neni 3

Administrata komunale:

- Përgatit aktet për Këshillin dhe për Kryetarin e Komunës;
- Përgatit seancat e Këshillit, si dhe



- Советот, како и седниците на неговите постојани и повремени комисији;
- Врши стручни работи за Советот и за Градоначалникот;
 - Го води сметководството на општината;
 - Ја следи проблематиката во областите од надлежност на општината, врши анализа на состојбата и дава иницијативи и предлози за нивно решавање;
 - Доставува информации и податоци во врска со активностите на општината на барање на надлежните органи или врз основа на закон;
 - Ракува со документите на општината, и ги чува сè до нивно уништување, односно предавање на Државниот архив на Република Македонија и
 - Врши и други работи што ќе и ги определи Советот и Градоначалникот.
- seancat e komisioneve të përhershme dhe të përkohshme të tij;
- Kryen punë profesionale për Këshillin dhe për Kryetarin e Komunës;
 - Udhëheq kontabilitetin e komunës;
 - Ndjek problematikën nga fusha e kompetencës së komunës, kryen analizë të gjendjes dhe jep iniciativa dhe propozime për zgjidhjen e tyre;
 - Dorëzon informata dhe të dhëna në lidhje me aktivitetet e komunës me kërkesë të organeve kompetente ose në bazë të ligjit;
 - Administron me dokumentet e komunës, dhe i ruan deri në asgjësimin e tyre, përkatësisht dorëzimin e tyre deri te Arkivi shtetëror i Republikës së Maqedonisë dhe
 - Kryen edhe punë të tjera që do t'i përcaktojë Këshilli dhe Kryetari.

Член 4

За вршење на стручни, нормативно-правни, извршни, управни работи и други работи во чии рамки Општината самостојно одлучува, како и за надлежностите кои и се доверени на Општината, Општинската администрација се организира во сектори, одделенија и Територијална противпожарна единица. Покрај секторите, одделенијата и Територијалната противпожарна единица во рамките на Општинската администрација, под директна надлежност на Градоначалникот функционира Одделение за внатрешна ревизија.

II. ВИДОВИ НА ОРГАНИЗАЦИОНИ ОБЛИЦИ

Член 5

Општинската администрација ја сочинуваат:

Neni 4

Për kryerjen e punëve profesionale, normativo-juridike, ekzekutive, administrative dhe punë të tjera në kuadër të të cilave Komuna vendos në mënyrë të pavarur, si dhe për kompetencat të cilat i janë besuar Komunës, Administrata komunale organizohet në sektorë, seksione dhe Njësinë territoriale zjarrfikëse.

Përveç sektorëve, seksioneve dhe Njësisë territoriale zjarrfikëse në kuadër të Administratës komunale, nën kompetencë të drejtpërdrejtë të Kryetarit të Komunës funksionon Seksioni për revizion të brendshëm.

II. LLOJET E FORMAVE ORGANIZATIVE

Neni 5

Administratën komunale e përbëjnë:



- | | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> ➤ Секторот за правни, финансиски, развојни, општи работи и јавни дејности, ➤ Секторот за урбанизам, комунални работи, сообраќај и заштита на животна средина, ➤ Одделението за инспекциски надзор ➤ Одделението за внатрешна ревизија ➤ Одделението за управување со човечки ресурси и ➤ Територијалната противпожарна единица. | <ul style="list-style-type: none"> ➤ Секторот за правни, финансиски, развојни, општи работи и јавни дејности, ➤ Секторот за урбанизам, комунални работи, сообраќај и заштита на животна средина, ➤ Одделението за инспекциски надзор ➤ Одделението за внатрешна ревизија ➤ Одделението за управување со човечки ресурси и ➤ Територијалната противпожарна единица. |
|--|--|

III. СЕКТОР ЗА ПРАВНИ, ФИНАНСИСКИ, РАЗВОЈНИ, ОПШТИ РАБОТИ И ЈАВНИ ДЕЈНОСТИ

Член 6

Секторот за правни, финансиски, развојни, општи работи и јавни дејности се состои од:

1. Одделение за правни, општи работи, месна самоуправа и односи со јавност,
2. Одделение за финансирање, буџет, општински имот и администрирање со даноци и имот.
3. Одделение за локален економски развој и имплементација на проекти

IV. СЕКТОР ЗА УРБАНИЗАМ, КОМУНАЛНИ РАБОТИ, СООБРАЌАЈ И ЗАШТИТА НА ЖИВОТНАТА СРЕДИНА

Член 7

Секторот за урбанизам, комунални работи, сообраќај и заштита на животна средина се состои од:

1. Одделение за урбанизам и заштита на животната средина.
2. Одделение за комунални работи,

III. SEKTORI PËR PUNË JURIDIKE, FINANCIARE, ZHVILLIMORE, TË PËRGJITHSHME DHE VEPRIMTARI PUBLIKE

Neni 6

Sektori për punë juridike, financiare, zhvillimore, të përgjithshme dhe veprimtari publike përbëhet nga:

1. Seksioni për punë juridike, të përgjithshme, vetëqeverisje vendore dhe marrëdhënie me publikun,
2. Seksioni për financim, buxhet, pronë komunale dhe administrim me tatimet dhe pronën
3. Seksioni për zhvillim ekonomik lokal dhe implementimin e projekteve

IV. SEKTORI PËR URBANIZËM, PUNË KOMUNALE, KOMUNIKACION DHE MBROJTJE TË MJEDISIT JETËSOR

Neni 7

Sektori për urbanizëm, punë komunale, komunikacion dhe mbrojtje të mjedisit jetësor përbëhet nga:

1. Seksioni për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit jetësor
2. Seksioni për punë komunale,



сообраќај и патишта

komunikacion dhe rrugë

V. ТЕРИТОРИЈАЛНА ПРОТИВПОЖАРНА ЕДИНИЦА

V. NJËSIA TERRITORIALE ZJARRFIKËSE

Член 8

Neni 8

Територијалната противпожарна единица своите работи ги извршува организирана преку: Командирот на единицата, одделенијата и групите.

Njësia territoriale zjarrfikëse punët e saj i kryen e organizuar nëpërmjet: Komandantit të njësisë, seksioneve dhe grupeve.

VI. ДЕЛОКРУГ И НАЧИН НА ИЗВРШУВАЊЕ НА ЗАДАЧИТЕ

VI. FUSHËVEPRIMI DHE MËNYRA E KRYERJES SË DETYRAVE

A. СЕКТОР ЗА ПРАВНИ, ФИНАНСИСКИ, РАЗВОЈНИ, ОПШТИ РАБОТИ И ЈАВНИ ДЕЈНОСТИ

A. SEKTORI PËR PUNË JURIDIKE, FINANCIARE, ZHVILLIMORE, TË PËRGJITHSHME DHE VEPRIMTARI PUBLIKE

A.1. ОДДЕЛЕНИЕ ЗА ПРАВНИ, ОПШТИ РАБОТИ, МЕСНА САМОУПРАВА И ОДНОСИ СО ЈАВНОСТ

A.1. SEKSIONI PËR PUNË JURIDIKE, TË PËRGJITHSHME, VETËQEVERISJE VENDORE DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Член 9

Neni 9

Одделението за правни, општи работи, месна самоуправа и односи со јавност ги врши работите што се однесуваат на подготвување на нормативни акти (одлуки и други општи акти) од надлежност на Советот, односно Градоначалникот на Општината, дава мислење на прописи од аспект на нивната законитост кога предлагачи се други органи, врши стручни и организациони работи за функционирање на Советот и на неговите тела, односно на Градоначалникот, ја организира и се грижи за работата на месната самоуправа, се грижи за извршување на одлуките во надлежност на Советот, дава правна помош на граѓаните, врши работи кои произлегуваат од работниот однос на вработените во општинската администрација, се грижи за работите од цивилната заштита и противпожарната заштита, архивското работење, дактилографските работи, секретарски

Seksioni për punë juridike, të përgjithshme, vetëqeverisje vendore dhe marrëdhënie me publikun kryen punë që kanë të bëjnë me përgatitjen e akteve normative (vendimeve dhe akteve tjera të përgjithshme) në kompetencë të Këshillit, përkatësisht Kryetarit të Komunës, jep mendim për dispozitat nga aspekti i ligjshmërisë së tyre kur propozues janë organet tjera, kryen punë profesionale dhe organizative për funksionimin e Këshillit dhe trupave të tij, përkatësisht Kryetarit të Komunës, organizon dhe kujdeset për punën e vetëqeverisjes vendore, kujdeset për ekzekutimin e vendimeve nga kompetenca e Këshillit, u jep ndihmë juridike qytetarëve, kryen punë që dalin nga marrëdhënia e punës të të punësuarve në administratën komunale, kujdeset për punët nga mbrojtja civile dhe mbrojtja kundër zjarrit, punën arkivore, punët daktilografike, punët sekretarike për Kryetarin e Komunës, punën kancelarike e cila përfshin pranimin, hapjen, evidentimin dhe dërgimin e akteve të organeve të komunës, punët për parkun vozitës dhe punë



работи за Градоначалникот, канцелариското работење кое го опфаќа приемот, отворањето, евиденцијата и испраќањето на актите на органите на општината, работи за возниот парк и други помошно технички работи (кафе кувар и хигиеничар), работите што се однесуваат на следење на состојбата во областите на културата, спортот, социјалната заштита, образованието и здравството во рамките на надлежностите кои Општината задолжително ги извршува, согласно закон ги следи прописите и дава мислење од овие области, ги информира корисниците на услугите за полесно остварување на нивните права, обезбедува информации за Советот на Општината, Градоначалникот и општинската администрација, врши информативни и протоколарни работи за потребите на Советот и Градоначалникот, иницира, предлага и учествува во подготовката, изработката и иновирањето на упатства, прирачници, инструкции, насоки и други стручни нормативни акти од областа на односите со јавноста, се грижи за меѓународна соработка на општината, се грижи за соработката со здруженијата на граѓани и фондации, предлага мерки и активности што треба Советот и Градоначалникот да ги преземаат во овие области, врши и други работи што ќе му бидат ставени во надлежност согласно законите и други прописи, односно од страна на Градоначалникот и Советот.

A.2. ОДДЕЛЕНИЕ ЗА ФИНАНСИРАЊЕ, БУЏЕТ, ОПШТИНСКИ ИМОТ И АДМИНИСТРИРАЊЕ СО ДАНОЦИ

Член 10

Одделението за финансирање, буџет, општински имот и администрирање со даноци ги врши работите што се однесуваат на: подготвување на Буџетот и Годишната сметка на Буџетот и други акти од областа на финансирањето, а што се од надлежност на Општината, се грижи за администрирањето со даноците и

тө тјера ndihmëse teknike (banakier dhe higjienist), punët që kanë të bëjnë me ndjekjen e gjendjes në sferat e kulturës, sportit, mbrojtjes sociale, arsimit dhe shëndetësisë në kuadër të kompetencave të cilat Komuna domosdoshmërisht i kryen, në përputhshmëri me ligjin, ndjek dispozitat dhe jep mendim nga këto sfera, i informon shfrytëzuesit e shërbimeve për realizim më të lehtë të të drejtave të tyre, siguron informata për Këshillin e Komunës, Kryetarin dhe administratën komunale, kryen punë informative dhe protokollare për nevojat e Këshillit dhe të Kryetarit të Komunës, inicon, propozon dhe merr pjesë në përgaditjen dhe inovimin e udhëzimeve, doracakëve, instruksioneve, drejtimeve dhe akteve tjera normative profesionale nga lëmi i marrëdhënieve me publikun, kujdeset për bashkëpunimin ndërkombëtar të komunës, kujdeset për bashkëpunimin me shoqatat qytetare dhe fondacionet, propozon masa dhe aktivitete që Këshilli dhe Kryetari i Komunës duhet t'i ndërmarrin në këto lëmi, kryen edhe punë të tjera që do t'i jepen si kompetencë në përputhshmëri me ligjet dhe dispozitat tjera, përkatësisht nga ana e Kryetarit të Komunës dhe Këshillit.

A.2. SEKSIONI PËR FINANCIM, BUXHET, PRONË KOMUNALE DHE ADMINISTRIM ME TATIMET

Neni 10

Seksioni për financim, buxhet, pasuri komunale dhe administrim me tatimet kryen punë që kanë të bëjnë me përgatitjen e Buxhetit dhe Llogarisë vjetore dhe akte të tjera nga sfera e financimit, e që janë në kompetencë të Komunës; kujdeset për administrimin me tatimet dhe taksat komunale; bën planifikimin e të hyrave, përcaktimin e



комуналните такси, врши планирање на приходи, нивно утврдување и наплата; води евиденција на даночни обврзници; води регистар на недвижен и подвижен имот со имиња и адреси на даночните обврзници, вкупна површина и вредност; врши усогласување на состојбата на регистарот на недвижности со состојбата на недвижности во геодетската управа; спроведува постапка за присилна наплата на локални даноци и такси; ја води и ускладува евиденцијата на имотот на Општината, ги следи и применува прописите за финансиско работење, сметководство и материјално работење на органите на Општината и на месната самоуправа, ги следи, проучува и дава мислење на прописите од финансиите, го известува Советот и Градоначалникот за промена на прописите од интерес на финансирањето, поднесува извештаи за состојбите на сметката до Комисијата за финансирање, буџет и локален економски развој на Советот и на нејзино барање доставува извештаи за состојбите на сметката и податоци од значење за финансиското работење, врши и други работи што ќе му бидат дадени во надлежност согласно законите и други прописи, како и од страна на Градоначалникот и Советот.

А.3. ОДДЕЛЕНИЕ ЗА ЛОКАЛЕН ЕКОНОМСКИ РАЗВОЈ И ИМПЛЕМЕНТАЦИЈА НА ПРОЕКТИ

Член 11

Одделението за локален економски развој и имплементација на проекти ги врши работите што се однесуваат на локалниот економски развој за што подготвува програми и предлага мерки за поддршка на малите и средните претпријатија и претприемаштвото на локално ниво во земјоделието, сточарството, шумарството, водоснабдување и развојот на локалната агроберза, изготвува планови за локален економски развој, го следи извршувањето на плановите и предлага мерки за нивно остварување, обезбедува документациона база на податоци за потребите на

tyre dhe inkasimin; mban evidencën e obliguesve tatimorë; mban regjistrin e pasurive të patundshme me emra dhe adresa të obliguesve tatimorë, për sipërfaqen e përgjithshme dhe vlerën; bën përshtatjen e gjendjes së regjistrin të patundshmërive me gjendjen e patundshmërive në drejtorinë e gjeodezisë; zbaton procedurën për inkasimin e dhunshëm të tatimeve lokale dhe taksave; udhëheq dhe përshtat evidencën e pasurisë së Komunës, i ndjek dhe i zbaton dispozitat nga puna financiare, kontabiliteti dhe puna materiale e organeve të Komunës si dhe të vetëqeverisjes vendore; ndjek, studion dhe jep mendim për dispozitat nga financat, njofton Këshillin dhe Kryetarin e Komunës për ndryshimet në dispozitat që kanë të bëjnë me financimin, dërgon raporte për gjendjen e llogarisë deri te Komisioni për financim, buxhet dhe zhvillim ekonomik lokal të Këshillit dhe me kërkesë të tij dërgon raporte për gjendjet e llogarisë si dhe të dhëna me rëndësi për punën financiare, kryen edhe punë të tjera që do t'i jepen në kompetencë në përputhshmëri me ligjet dhe dispozitat tjera, si dhe nga ana e Kryetarit të Komunës dhe Këshillit.

A.3.SEKSIONI PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL DHE IMPLEMENTIMIN E PROJEKTEVE

Neni 11

Seksioni për zhvillim ekonomik lokal dhe implementimin e projekteve kryen punë që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik lokal për çka përgatit programe dhe propozon masa për përkrahje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrësisë në nivel lokal në bujqësi, blegtori, pylltari, furnizimin me ujë dhe zhvillimin e agroberzës lokale, përgadit plane për zhvillim ekonomik lokal, e përcjell ekzekutimin e planeve dhe propozon masa për realizimin e tyre, siguron dokumentacione bazë me të dhëna për nevojat e planifikimit dhe programimit të zhvillimit ekonomik,



планирањето и програмирање на економскиот развој, изготвува предлог одлуки и други општи и конкретни акти од надлежност на Советот и Градоначалникот од областа на економскиот развој, иницира утврдување на развојни и структурни приоритети, како и основи мерки за водење на локална економска политика на општината, иницира и развива регионална и меѓугранична соработка, учествува во воспоставувањето и развојот на мрежа на институции и агенции и промовирање на партнерството, остварува соработка со меѓународни организации, невладини, хуманитарни и други организации, се грижи за развојот на информатичката технологија и нејзиното вклучување во функционирањето на општината, врши и други работи што ќе му бидат ставени во надлежност со закон или друг пропис, односно од страна на Градоначалникот и Советот.

VII. СЕКТОР ЗА УРБАНИЗАМ, КОМУНАЛНИ РАБОТИ, СООБРАЌАЈ И ЗАШТИТА НА ЖИВОТНАТА СРЕДИНА

A.1. ОДДЕЛЕНИЕ ЗА УРБАНИЗАМ И ЗАШТИТА НА ЖИВОТНАТА СРЕДИНА

Член 12

Одделението за урбанизам и заштита на животна средина ги врши работите што се однесуваат на: следење на состојбата во областа на урбанизмот на подрачјето на Општината и покренува иницијативи и предлози за донесување или изменување на детални урбанистички планови, ги прибира и стручно обработува барањата и иницијативите од физички и правни лица за измена на детални урбанистички планови, ја подготвува документацијата и информационата основа за покренување постапка за изработка, донесување или изменување на детални урбанистички планови на Општината, учествува во изработка на Програмата за уредување на градежно земјиште на подрачјето на

përgadit propozim vendime dhe akte tjera të përgjithshme dhe konkrete nga kompetencat e Këshillit dhe Kryetarit në lëminë e zhvillimit ekonomik, inicon përcaktimin e prioriteteve zhvillimore dhe strukture si dhe baza dhe masa për udhëheqjen e politikës ekonomike të komunës, inicon dhe zhvillon bashkëpunim rajonal dhe ndërkuftar, merr pjesë në vendosjen dhe zhvillimin e rrjetit të institucioneve dhe agjencive dhe promovimin e partneritetit, realizon bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, joqeveritare, humanitare dhe organizata të tjera, kujdeset për zhvillimin e teknologjisë informatike dhe inkuadrimit e saj në funksionimin e komunës, kryen edhe punë të tjera të cilat do t'i jepen në kompetencë me ligj ose me ndonjë dispozitë tjetër, respektivisht nga ana e Kryetarit të Komunës dhe Këshillit.

VII. SEKTORI PËR URBANIZËM, PUNË KOMUNALE, KOMUNIKACION DHE MBROJTJE TË MJEDISIT JETËSOR

A.1. SEKSIONI PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT JETËSOR

Neni 12

Seksioni për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit jetësor kryen punë që kanë të bëjnë me përcjelljen e gjendjes nga sfera e urbanizmit në territorin e Komunës dhe ndërmerr iniciativa dhe propozime për sjelljen ose ndryshimin e planeve detale urbanistike, grumbullon dhe profesionalisht i përpunon kërkesat dhe iniciativat nga personat fizikë dhe juridikë për ndryshimin e planeve detale urbanistike, përgatit dokumentacionin dhe bazën e informatave për ngritje të procedurës për përpunimin, sjelljen ose ndryshimin e planeve detale urbanistike të Komunës, merr pjesë në përpunimin e Programit për rregullim të tokës ndërtimore në territorin e Komunës, përgadit analiza dhe informata për gjendjen në planifikimin hapsinor, përgadit program vjetor



Општината ја, подготвува анализи и информации за состојбите во урбанистичкото планирање, подготвува годишна програма за урбанистичко планирање на просторот; издава локациски услови и одобренија за градба на објекти од локално значење утврдени со закон, го следи спроведувањето на урбанистичките планови, ги следи и проучува прописите од својата област, ги следи состојбите сврзани со работите за заштита и унапредување на животната средина и природата, ја следи состојбата и превзема мерки на планот на дезинфекција, дезинскесија и ерадикација на амбиентот, врши проценка и превзема мерки за заштита и спречување од загадување на водата, воздухот, земјиштето, заштита од бучава и зрачење; изготвува, и реализира одлуки, програми, акциони планови и други акти од надлежната област, врши и други работи што ќе му бидат доверени во надлежност согласно законите и други прописи, како и од страна на Градоначалникот и Советот.

A.2. ОДДЕЛЕНИЕ ЗА КОМУНАЛНИ РАБОТИ, СООБРАЌАЈ И ПАТИШТА

Член 13

Предлага и реализира прописи во комуналните дејности, ја следи снабдувањето со вода за пиење, одведувањето и пречистувањето на отпадни води, одведувањето и третманот на атмосферски води, врши надзор и превзема мерки за одржувањето на јавната чистота, снабдување со природен гас и топлинска енергија, одржување на комунални уреди (фонтани, чешми, градски часовници и др.), украсување на населени места, уредување и одржување на јавното осветлување, регулација, одржување на коритото на реката Вардар, определување на имиња на улици, плоштади, мостови и други инфраструктурни објекти, води регистар за нив согласно закон, ги врши работите што се однесуваат на уредувањето на

për planifikimin urbanistik hapsinor, jep kushte lokacioni dhe leje për ndërtim të objekteve në nivel lokal të përcaktuara me ligj, përcjell realizimin e planeve urbanistike, i përcjell dhe i studion dispozitat nga sfera e vet, përcjell gjendjen lidhur me punët për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës, e përcjell gjendjen dhe ndërmerr masa në planin e dezinfektimit, dezinfektimit dhe eradikimit të ambientit, bën vlerësimin dhe ndërmerr masa për mbrojtjen nga ndotja e ujërave, ajrit, tokës, mbrojtjen nga zhurma dhe rrezatimet e ndryshme, përgadit dhe zbaton vendime, programe, plane aksionale dhe akte tjera në sferën e kompetencave të veta, kryen edhe punë të tjera që do t'i besohen në kompetencë, në përputhshmëri me ligjet dhe dispozitat tjera, si dhe nga ana e Kryetarit të Komunës dhe Këshillit.

A.2. SEKSIONI PËR PUNË KOMUNALE, KOMUNIKACION DHE RRUGË

Neni 13

